

LIGJ PËR SISTEMIN NJËSPORTELE DHE PËR UDHËHEQJEN E REGJISTRIT TREGTAR DHE REGJISTRIT TË PERSONAVE TË TJERË JURIDIKË

TEKST I KONSOLIDUAR ¹

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Përmbajtja e ligjit

Neni 1

(1) Me këtë ligj rregullohet/rregullohen sistemi njësportel, mbajtja e regjistrit tregtar dhe e regjistrit të personave tjerë juridikë, regjistrin të personave fizikë dhe juridikë të cilëve u është shqiptuar sanksion ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë dhe detyrës dhe ndalim i përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë së veçantë, regjistrin të dënimeve për veprat e kryera penale të personave juridikë nga Regjistrin Qendror i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: Regjistrin Qendror) me shkrim dhe në formë elektronike si dhe marrja e mbajtjes së regjistrit tregtar, regjistrin gjyqësor, regjistrin të bashkësive të ujit, regjistrin të ekonomive të ujërave, regjistrin të shoqatave dhe fondacioneve dhe regjistrin të odave të gjykatave kompetente nga Regjistrin Qendror.

(2) Nëse me ligjin me të cilin është përcaktuar udhëheqja e regjistrin nuk është përcaktuar procedura për udhëheqjen e këtij regjistrin, regjistrimi do të bëhet sipas rregullave për procedurën e përcaktuar në këtë ligj.

Kuptimi i nocioneve të përdorura në këtë ligj


Neni 2

Shprehje të veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:


1. "Shifër kryesore e të hyrave" janë numrat dhe shkronjat me të cilat theksohet veprimtaria e cila ka pjesëmarrje më të madhe në strukturën e të hyrave të realizuara të subjektit të regjistrimit në pajtim me Klasifikimin nacional të veprimtarisë (KNV)
2. "Sistem njësportel", është sistem i cili mundëson pranimin, përpunimin, distribuimin dhe qasjen unike ndaj të dhënave të përcaktuara me ligj, të regjistruara në regjistrin tregtar, në regjistrin e personave të tjerë juridikë, dhe regjistrat e tjerë themelorë të themeluar me ligj me rëndësi për subjektet në regjistrim;

Teksti në gjuhën

Maqedonase

 Закон за
едношалтерскиот
систем и за водење
на трговскиот
регистар и регистар
на други правни
лица

Teksti në gjuhën Angleze

 Law on the One-
Stop-Shop System
and Keeping a Trade
Register and a
Register of Other
Legal Entities

- 2-a. "Sistem për e-regjistrim" është sistemi informatik që mundëson parashtrim të fletëparaqitjes nëpërmjet Internetit dhe evidentimin, përpunimin, ruajtjen e tyre dhe shkëmbimin e të dhënave dhe dokumenteve në formë elektronike;
3. "Protokoll elektronik" është protokoll i të gjitha fletëparaqitjeve të pranuar nga zyrat e regjistrimit të Regjistrisë qendrore që udhëhiqet në formë elektronike;
4. "Formular unik elektronik" është sistemi elektronik për futjen dhe përpunimin e të dhënave, i përcaktuar dhe përgatitur nga Regjistrisë qendrore.
5. "Përmbledhje e shtojcave" është pjesa e regjistrisë në të cilën bashkëngjiten dokumentet dhe dëshmitë e secilit subjekt të regjistruar;
6. "Deklaratë e vërtetuar te noteri" është deklarata nënshkrimi i së cilës është vërtetuar te noteri;
7. "Numër unik amë i subjektit të regjistrimit në regjistër" (NUAS) është numri unik, i pandryshueshëm, i papërsëritshëm, identifikues i subjektit të regjistrimit, i cili përcaktohet në formë elektronike;
8. "Konkluzion" është vendimi me të cilin vendoset për çështje që kanë të bëjnë me procedurën, si dhe për ato çështje të cilat si detyësore do të paraqiten lidhur me zbatimin e procedurës, e për të cilat nuk merret aktvendim.
9. Klasifikim nacional i veprimtarive (KNV) është standardi nacional i harmonizuar me klasifikimin evropian të veprimtarive (NACE) dhe përdoret për identifikimin, grupimin dhe përkufizimin e veprimtarive sipas të cilave bëhet sistemimi i subjekteve afariste.
10. "Modul 11" është formula aritmetike për ndarjen e numrave të papërsëritshëm.
11. "Regjistra themelore" janë regjistra dhe emërtues të themeluar me ligj dhe të cilët udhëhiqen në dhe jashtë Regjistrisë qendrore;
12. "Person i autorizuar për regjistrim" është personi i punësuar në Regjistrinë qendrore, i cili sipas këtij ligji autorizohet që të kryejë regjistrimin e subjekteve të regjistrimit;
- 12-a. Agjent regjistruar është individ tregtar apo shoqëri tregtare që është regjistruar për kryerje të veprimtarisë së kontabilitetit, avokat dhe shoqëri e avokatit që kanë autorizim për parashtrimin e fletëparaqitjes për regjistrim përmes Sistemit për e-regjistrim;
13. "Parashënim i të dhënave" është regjistrimi të cilin e kryen Regjistrisë qendrore në regjistër pa aktvendim të marrë;
14. "Fletëparaqitje për regjistrim" është formulari i përcaktuar, i parashtruar nga paraqitësi i autorizuar, në të cilën përmbahet kërkesa për regjistrim në regjistër;
15. "Klauzolë e përgjithshme për biznes" është shenja që subjekti në regjistrim në regjistrinë tregtare mund t'i kryejë të gjitha veprimtaritë sipas Klasifikimit nacional të veprimtarive (KNV);
16. "Veprimtari prioritar" është veprimtaria e KNV me kryerjen e së cilës subjekti në regjistrim ka për qëllim të realizojë pjesën më të madhe nga të hyrat e përgjithshme në vitin e parë në të cilin e ka kryer regjistrimin;

17. "Regjistra të veçantë" janë regjistrat që udhëhiqen në pajtim me ligjin dhe dispozitën tjetër, në të cilat evidentohen të dhënat relevante juridike për shoqëritë tregtare dhe personat e tjerë juridikë (licencat, lejet, koncesionet, kategorizimet dhe ngjashëm).

18. "Regjistri/a" sipas këtij ligji janë regjistri tregtar dhe regjistri i personave të tjerë juridikë;

19. "Aktvendim për regjistrim" është akti i përpunuar në formë të formularit përkatës për llojin e regjistrimit;

20. "Aktvendim për hedhjen poshtë të fletëparaqitjes për regjistrim" është akti me të cilin arsyetohen shkaqet për hedhjen poshtë të fletëparaqitjes së regjistrimit në regjistër;

21. "Subjekt i regjistrimit" është subjekti për të cilin me ligj është përcaktuar të bëhet regjistrimi në regjistrat themelorë dhe subjekte të tjera juridike të themeluara me ligj.

22. "Regjistër tregtar" dhe "Regjistër i personave të tjerë juridikë" janë libra publikë që paraqesin bazën unike elektronike të të dhënave e cila përmban të dhëna dhe shtojca (dokumente dhe dëshmi) për subjektet e regjistrimit për të cilat regjistrimi është përcaktuar me ligj.

23. "Regjistri i personave fizikë dhe juridikë të cilëve u është kumtuar sanksion ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe ndalim të përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë së caktuar" është libër publik i cili paraqet bazë të vetme elektronike të të dhënave i cili ka të dhëna nga evidenca e sanksioneve kundërvajtëse të gjykatave të shkallës së parë për persona fizikë dhe juridikë të cilëve u është kumtuar sanksion ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe ndalim të përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë së caktuar, të përcaktuara me Ligjin për kundërvajtje;

24. "Regjistri i dënimeve për vepra të kryera penale të personave juridikë" është libër publik që paraqet bazë unike elektronike të të dhënave, që përmban të dhëna nga evidenca ndëshkuese e aktgjykimeve të plotfuqishme gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë për dënimet kryesore dhe dytësore, për vepra të kryera penale të personave juridikë të përcaktuara me Kodin penal të Republikës së Maqedonisë.

II SISTEMI NJË SPORTEL

Funksioni i sistemit njësportel

Neni 3

Përmes Sistemit njësportel mundësohet:

- 1) sigurimi i të dhënave të cilat janë të obligueshme për fillimin e punës së subjekteve në regjistrim;
- 2) unifikimi i të gjitha të dhënave juridike relevante në një zgjidhje juridikisht valide për fillimin e punës dhe realizimin e të drejtave të subjektit të caktuar dhe qasjen e të dhënave;
- 3) qasja në regjistrimet në regjistrat themelorë dhe të veçantë ose në bazat e të dhënave, të cilat në pajtim me ligjin udhëhiqen në Republikën e Maqedonisë ose jashtë saj, kur kjo është me rëndësi për vendosjen dhe funksionimin e sistemit njësportel;
- 4) shfrytëzimi i të dhënave nga subjektet të cilat në bazë të marrëveshjes fusin të dhëna të caktuara me rëndësi për sistemin njësportel.

Neni 3-a

(1) Drejtorët e falimentimit, nëpërmjet sistemit njësportel fusin të dhëna për procedura të falimentimit të cilat mbahen në gjykata kompetente në Republikën e Maqedonisë në pajtim me Ligjin për falimentim.

(2) Ministri i Ekonomisë e përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e futjes së të dhënave nëpërmjet sistemit njësportel për procedurat falimentuese të cilat mbahen në gjykata kompetente në Republikën e Maqedonisë në pajtim me Ligjin për falimentim.

Punët të cilat kryhen përmes sistemit njësportel

Neni 4

(1) Regjistri qendror përmes sistemit njësportel kryen:

- përcaktimin dhe ndarjen e Numrit unik amë të subjektit të regjistrimit (NUAS);
- përcaktimin e emrit dhe shifrës së veprimtarisë prioritare sipas KNV-së;
- përcaktimin e shifrës së formës organizative të subjektit;
- futjen e Numrit unik tatimor (NUT) të subjektit në regjistrim;
- futjen e llogarisë së bankës sipas zgjedhjes së subjektit në regjistrim;
- dhe të dhëna të tjera me rëndësi për subjektin në regjistrim.
- futja e të dhënave për punësimin e parë të personave të autorizuar për përfaqësim (përfaqësues sipas ligjit) të subjekteve në regjistrim dhe përfshirjen e tyre në sigurimin e obligueshëm social (sigurimin pensional, invalidor dhe shëndetësor) nëse është parashtruar fletëparaqitje, dhe
- dhënia e certifikatës elektronike subjekteve në regjistrim të cilat janë dhënë prej botuesve të autorizuar të certifikatave elektronike.

(2) Të dhënat nga paragrafi (1) të këtij neni, Regjistri qendror i fut në formularin përkatës për regjistrim, në pajtim me dispozitën nga neni 23 të këtij Ligji.

(3) Regjistri qendror e ndan dhe ndryshon shifrën kryesore të të hyrave

(4) Regjistri Qendror nëpërmjet sistemit njësportel siguron zgjidhje elektronike për futjen e të dhënave nga neni 3-a paragrafi (1) i këtij ligji.

(5) Regjistri Qendror nëpërmjet sistemit njësportel siguron zgjidhje elektronike për mbajtjen e regjistrit të personave të cilët nuk mund të themelojnë dhe menaxhojnë shoqëri tregtare në Republikën e Maqedonisë, në pajtim me dispozitat e Ligjit për shoqëri tregtare.

(6) Regjistri Qendror nëpërmjet sistemit njësportel e siguron paraqitjen e të dhënave afariste dhe financiare për subjekte të cilat janë regjistruar në regjistra dhe të dhënave tjera me të cilat disponon, në gjuhë softuerike të standardizuar, të pranuar ndërkombëtarisht.

Lidhjet e regjistrave me organet, organizatat shtetërore dhe tjera, dhe subjektet tjera

Neni 5

(1) Për vendosjen dhe funksionimin e sistemit njësportel, organet kompetente shtetërore dhe institucionet e organizatat e tjera, të cilat udhëheqin regjistra themelore dhe të veçantë dhe që disponojnë me të dhëna me rëndësi për realizimin e të drejtës, obligohen të bashkëpunojnë përmes sistemit njësportel me Regjistrin qendror dhe t'i paraqesin të

dhënat me të cilat disponojnë pa kompensim, si dhe të japin sqarime dhe ndihmë lidhur me kryerjen e punëve nga kompetenca e vet. Organet kompetente dhe institucionet e organizatat tjera, të cilat sipas ligjit udhëheqin regjistra themelorë dhe të veçantë, obligohen që t'i mundësojnë Regjistrin qendror shfrytëzimin e papenguar të të dhënave të tyre.

(2) Regjistri qendror siguron pikë kyçeje në sistemin njësportel nëpërmjet infrastrukturës së vet për ndërlidhje elektronike të regjistrave të vet me regjistra të tjerë ose baza të dhënash të cilat mbahen në pajtim me ligjin.

(3) Lidhja me Regjistrin qendror kryhet në bazë të procedurave unike dhe formularëve në formë elektronike ose formë tjetër, përmes lidhjeve të sigurta, për shkak të arritjes së racionalizimit në punën dhe qasjen e tyre më të lehtë dhe më të shpejtë në sistemin njësportel.

(4) Shpenzimet për lidhjen elektronike, e cila mundëson këmbimin e të dhënave me subjektet pjesëmarrëse në sistemin njësportel, i bart secila palë - pjesëmarrëse.

Ndarja e numrit unik amë të subjektit (NUAS)

Neni 6

(1) Secili subjekt i regjistrimit merr numrin unik amë të subjektit (NUAS), i cili përbëhet nga numri shtatëshifror, që ndahet në formë elektronike sipas modulit 11, gjatë regjistrimit të parë.

(2) Numri unik amë i subjektit të regjistrimit (NUAS) është identifikuesi unik i subjektit të regjistrimit gjatë realizimit të të drejtave dhe obligimeve të veta në organet dhe organizatat kompetente shtetërore dhe institucionet e tjera të përcaktuara me ligj. NUAS është identifikuesi unik që shfrytëzohet në komunikimin dhe këmbimin e të dhënave me rëndësi për subjektet në regjistrim ndërmjet të gjitha organeve shtetërore, organizatave dhe institucioneve të tjera.

(3) Numri unik amë i subjektit të regjistrimit (NUAS), nuk mund të ndryshohet, as pas fshirjes së subjektit të regjistrimit t'i ndahet subjektit tjetër në regjistrim.

(4) Një subjekt në regjistrim nuk mund t'i ndahet më shumë se një numër unik amë i subjektit (NUAS).

(5) Dega ose njësia tjetër organizative e përcaktuar me ligj, shënohet me NUAS të subjektit të regjistrimit që e ka organizuar si dhe me nënnumrin e vet.

Klauzola e përgjithshme për biznes

Neni 7

(1) Klauzola e përgjithshme për biznes i mundëson subjektit regjistrim në regjistrin tregtar dhe kryerjen e të gjitha veprimtarive sipas Klasifikimit nacional të veprimtarive (KNV);

(2) Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni veprimtaritë për të cilat sipas KNV me ligj është përcaktuar që të kryhen vetëm në bazë të pëlqimit, lejes ose aktit tjetër të organit shtetëror, subjekti në regjistrim mund t'i kryejë pasi për veprimtarit të ketë marrë pëlqimin, lejen ose aktin tjetër të organit shtetëror në pajtim me ligjin;

(3) Për subjektet në regjistrim në regjistrin e personave tjerë juridikë futen të dhënat të cilat janë me rëndësi për kryerjen e veprimtarisë.

Veprimtaria prioritare

Neni 7-a

(1) Sipas veprimtarisë prioritare Regjistri qendror e fut subjektin e ri në regjistrim në të dhënat për shpërndarjen në sektorë të subjekteve sipas veprimtarive në Republikën e Maqedonisë;

(2) Veprimtaria prioritare nuk e përjashton, as nuk e kufizon zbatimin e klauzolës së përgjithshme për biznes në lidhje me asnjë subjekt në regjistrim;

(3) Personi i autorizuar për regjistrim në regjistër është i obliguar ta theksojë në fletëparaqitjen për regjistrim veprimtarinë prioritare.

(4) Veprimtaria prioritare vlen deri në ndarjen e shifrës kryesore të të hyrave.

Mënyra e përcaktimit të veprimtarisë kryesore

Neni 8

KNV e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e Entit Shtetëror të Statistikës.

Kushtet dhe mënyra e ndarjes dhe ndryshimit të shifrës kryesore të të hyrave

Neni 9

(1) Shifra kryesore e të hyrave i përgjigjet veprimtarisë përkatëse të KNV nga e cila subjekti ka realizuar të hyra më të mëdha në vitin në vijim;

(2) Regjistri qendror automatikisht u ndan shifër kryesore të të hyrave subjekteve të cilat janë regjistruar në regjistrin tregtar në bazë të Formularit të para të dorëzuar për ndarjen e të hyrave të realizuara sipas veprimtarive të subjektit për vitin paraprak;

(3) Regjistri qendror automatikisht bën kontrollimin e shifrës kryesore të të hyrave dhe në rast se konfirmon se të hyrat më të mëdha të realizuara janë nga veprimtari tjetër, të ndryshme nga ajo shifra e të hyrave të të cilës është regjistruar si kryesore, do ta fusë si kryesore shifrën e veprimtarisë nga e cila janë realizuar të hyrat më të mëdha;

(4) Për subjektet e reja të cilat do të regjistrohen në regjistrin tregtar, deri në dorëzimin e Formularit të parë për ndarjen e të hyrave të realizuara sipas veprimtarive, do t'u ndahet shifër kryesore e të hyrave në bazë të veprimtarisë prioritare të zgjedhur dhe të regjistruar.

Mënyra e përcaktimit të shifrës së formës organizative të subjektit

Neni 10

(1) Regjistri qendror kryen përcaktimin e shifrës së formës organizative të subjektit në regjistrim.

(2) Shifrat standarde të formave të organizimit të subjekteve afariste dhe personave të tjerë juridikë, i përcakton Regjistri qendror, pas mendimit paraprak të Entit shtetëror të statistikës.

Mënyra e futjes së NUT të subjektit në regjistrim

Neni 11

(1) Regjistri qendror përveç NUAS kryen edhe futjen e NUT të subjektit në regjistrim.

(2) Të gjitha subjekteve të cilave u ndahet NUAS, futja e NUT të përcaktuar nga Drejtoria për të hyra publike, kryhet vetëm sipas dispozitave të këtij ligji.

(3) Futja e NUT kryhet me këmbim elektronik ndërmjet Drejtorisë për të hyra publike dhe Regjistrin qendror. Drejtoria për të Hyra Publike dorëzimin e NUT e kryen në afat prej 90 minutash nga dorëzimi i të dhënave nga ana e Regjistrin qendror.

Llogaria e subjektit në regjistrim

Neni 12

(1) Subjekti në regjistrim zgjedh bankën në të cilën do ta hapë llogarinë e parë.

(2) Të dhënat për bankën në të cilën do ta hapë llogarinë e parë, subjekti në regjistrim i fut në formularin përkatës për regjistrim, në pajtim me nenin 23 të këtij ligji.

(3) Hapja e llogarisë së parë e subjektit në regjistrim bëhet me shkëmbimin elektronik të dërgesave në një kohë reale ndërmjet bankës afariste në të cilën hapet llogaria e parë dhe Regjistrin qendror, nëpërmjet regjistrin unik të llogarive të transaksionit.

Futja e të dhënave për punësimin e parë të personave të autorizuar për përfaqësim

Neni 12-a

(1) Futja e të dhënave për punësimin e parë të personave të autorizuar për përfaqësim (përfaqësues sipas ligjit) bëhet nëse është parashtruar fletëparaqitje nga subjekti në regjistrim.

(2) Subjekti në regjistrim fletëparaqitjen për punësimin e parë të personave të autorizuar për përfaqësim (përfaqësues sipas ligjit) e parashtron në formular të veçantë në pajtim me nenin 23 të këtij ligji.

(3) Futjen e të dhënave për punësimin e parë të personave të autorizuar për përfaqësim (përfaqësues sipas ligjit) dhe përfshirjen e tyre në sigurimin e obligueshëm social (sigurimi pensional, invalidor dhe shëndetësor), Regjistri qendror e bën në formë elektronike, nëpërmjet ndërlidhjes elektronike të regjistrave të vet me regjistrat dhe bazat e të dhënave të cilat mbahen në Agjencinë për punësim, Fondin për sigurim pensional dhe invalidor dhe Fondin për sigurim shëndetësor.

(4) Shpenzimet për ndërlidhjen elektronike dhe për shpërndarjen e të dhënave i bart çdo palë pjesëmarrëse të theksuara në paragrafin (3) të

këtij neni, e të verifikuara me marrëveshje të veçanta, të lidhura ndërmjet Regjistrat qendror dhe palëve pjesëmarrëse.

Certifikata elektronike

Neni 12-b

(1) Regjistri qendror si zyrë lokale regjistrimi u jep certifikata elektronike subjekteve në regjistrim të dhëna nga ana e botuesve të autorizuar të certifikatave elektronike.

(2) Regjistri qendror me botuesit e autorizuar të certifikatave elektronike lidh marrëveshje për pjesëmarrje në procedurën e regjistrimit të certifikatave elektronike.

Kalimi i të dhënave nga regjistrat tjerë

Neni 13

(1) Gjykatat, organet shtetërore, odat dhe institucionet e tjera që udhëheqin regjistra themelore (regjistri gjyqësor, regjistri i bashkësive ujore, regjistri i ekonomive ujore, regjistri i shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve, regjistri unik i partive politike, regjistri i odave, regjistri i organizatave sindikale, regjistri i përfaqësive të shoqërive të huaja, regjistri i bashkësive fetare dhe grupeve religjioze, emërtuesi i avokatëve, emërtuesi i noterëve, regjistri i zejtarëve dhe regjistra e emërtues të tjerë të përcaktuar me ligj), obligohen me detyrë zyrtare që të Regjistri qendror të paraqesin një ekzemplar të aktvendimit të regjistrimit, për sigurimin e të dhënave nga neni 4 të këtij ligji.

(2) Regjistrat qendrorë aktvendimit për regjistrim i bashkëngjitin fletëparaqitjen e përcaktuar në dispozitën e nenit 23 të këtij ligji, në të cilën subjekti i regjistrimit përcaktohet për të dhënat nga neni 4 të këtij ligji, si dhe dëshmia për kompensimin e paguar në pajtim me Tarifën e Regjistrat qendror.

(3) Pas kalimit të të dhënave nga aktvendimi për regjistrim dhe futjes së të dhënave nga neni 4 të këtij ligji, Regjistri qendror paraqet një ekzemplar nga aktvendimi të regjistrat themelore nga paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Regjistrat themelore nga paragrafi (1) të këtij neni, obligohen që të paraqesin një ekzemplar të aktvendimit për ndërrimin ose fshirjen e të dhënës së regjistruar.

(5) Të dhënat e futura në regjistrat themelore dhe të tjerë nga paragrafi (1) të këtij neni, kanë veprim juridik ndaj personave të tretë nga dita kur janë bartur në formë elektronike në mënyrë të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, dhe janë shpallur në ueb faqen e Regjistrat qendror.

Regjistri i personave fizikë dhe juridikë të cilëve u është kumtuar sanksioni ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe ndalim të përkohshme për kryerjen e veprimtarisë së caktuar

Neni 13-a

(1) Gjykatat të cilat mbajnë evidencë të sanksioneve kundërvajtëse të cilat janë të përcaktuara me Ligjin për kundërvajtje, janë të detyruar t'i

paraqesin të dhënat për personat fizikë dhe juridikë të cilëve u është kumtuar sanksion ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe ndalim të përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë së caktuar sipas detyrës zyrtare në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë për shkak të regjistrimit në regjistrin e personave fizikë dhe juridikë të cilëve u është kumtuar sanksioni ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe ndalim të përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë së caktuar.

(2) Ministri i Ekonomisë do ta përcaktoj formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të personave fizikë dhe juridikë të cilëve u është kumtuar sanksion ndalim të kryerjes të profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe ndalim të përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë së caktuar.

Regjistri i dënimeve për vepra të kryera penale të personave juridikë

Neni 13-b

(1) Gjykatat, vendimet e plotfuqishme për dënimet e shqiptuara kryesore dhe dytësore për vepra penale të kryera nga personat juridikë, me detyrë zyrtare i dorëzojnë në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, për regjistrim në regjistrin e dënimeve për vepra të kryera penale të personave juridikë.

(2) Dënimi kryesor shlyhet me detyrë zyrtare nga regjistri i paragrafit (1) të këtij neni, pas kalimit të tre viteve nga dita e dënimit të kryer ose të parashkruar.

(3) Dënimet dytësore nga neni 96-b pikat prej 1 deri në 6 të Kodit penal fshihen me detyrë zyrtare nga regjistri i theksuar, pas kalimit të kohës për të cilën janë shqiptuar.

(4) Ministri i Ekonomisë në bashkëpunim me ministrin e Drejtësisë i përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të dënimeve për vepra penale të kryera nga persona juridike.

Regjistri i kërkesave të caktuara të kreditorëve në procedurën për falimentim

Neni 13-v

I fshirë 2

Njoftimi pas regjistrimit të kryer

Neni 14

(1) Regjistri qendror pas regjistrimit të kryer i njofton organet dhe organizatat kompetente shtetërore, si vijon:

- 1) Drejtorinë doganore për subjektin në regjistrim që ka regjistruar lëndën e punës për qarkullim të jashtëm, për të dhënat e regjistruara të tij në regjistër;
- 2) Drejtorinë e të hyrave publike për NUT-në të futur për subjektin në regjistrim;
- 3) Bankën për të cilën subjekti në regjistrim është përcaktuar për hapjen e llogarisë së parë;
- 4) Entin shtetëror të statistikës për të dhënat e nevojshme për vendosjen, udhëheqjen dhe azhurnimin e regjistrit afarist statistikor.

(2) Të dhënat e regjistruara në regjistër, organet shtetërore kompetente dhe organizatat e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni mund t'i shfrytëzojnë ekskluzivisht për kryerjen e funksionit të vet të përcaktuar me ligj.

Këshilli profesional i sistemit njësportel

Neni 15

(1) Regjistri qendror përmes këshillit profesional siguron vendosjen dhe mirëmbajtjen e bazës unike metodologjike dhe teknologjike të sistemeve informative që janë me rëndësi për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të sistemit njësportel të përcaktuar me këtë ligj.

(2) Këshillin profesional e formon Drejtori i Regjistrimit qendror nga organet dhe organizatat që marrin pjesë në funksionimin e sistemit njësportel.

(3) Drejtori i Regjistrimit qendror në punën e këshillit profesional mund të fusë edhe persona të tjerë profesionalë.

(4) Formimi i këshillit profesional, numri i anëtarëve, mënyra e punës dhe vendimmarrjes, si dhe çështje të tjera, rregullohen me rregulloren e punës që e miraton këshilli profesional, ndërsa e verifikon drejtori i Regjistrimit qendror.

III. UDHËHEQJA E REGJISTRIT TREGTAR DHE E REGJISTRIT TË PERSONAVE TË TJERË JURIDIKË

1. DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

Parimet sipas të cilave udhëhiqen regjistrat dhe kryhen regjistrimet

Neni 16

(1) Regjistri tregtar dhe regjistri i personave të tjerë juridikë udhëhiqen si regjistra themelore në bazë të të cilëve konstituohen të drejtat e bazuara në ligj.

(2) Gjatë udhëheqjes së regjistrave, e veçanërisht gjatë futjes dhe veprimit me të dhënat në regjistra, Regjistri qendror u përmbahet parimeve si vijon:

1) transparencës, sipas së cilës të gjitha të dhënat nga regjistrat janë të kapshme për personat e interesuar, pa dëshminë për interesin juridik, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe;

2) vërtetësisë dhe ndërgjegjes, sipas së cilës personat e tretë që janë në qarkullim juridik, ose realizojnë ndonjë të drejtë besojnë në të dhënat nga regjistri, dhe nuk i bartin pasojat e dëmshme juridike që mund të shkaktohen nga regjistrimi i pavërtetë i të dhënës, ose për shkak të lëshimit në regjistrim të së dhënës në regjistër. Në rast të mospajtimit të së dhënës për regjistrimin e subjektit të regjistrimit të futur në regjistër, me të dhënë e regjistruar në bazat e të dhënave të regjistrave të tjerë, për personat e tretë të besueshme janë të dhënat e përmbajtura në regjistrat që udhëhiqen në pajtim me këtë ligj.

3) pavarësisë në vendosje sipas së cilës regjistruesi është i pavarur, në vendimmarrje në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me këtë dhe ligj tjetër.

- 4) arritshmërisë, sipas së cilës qasja te të dhënat nga regjistrat është e siguruar dhe mundësuar në mënyrë elektronike dhe mënyrë tjetër të përcaktuar;
- 5) ekonomizimit dhe efikasitetit, sipas të cilit procedura e regjistrimit, inspektimi në regjistër dhe lëshimi i ekstraktit të regjistrit, kryhet pa prolongim dhe me sa më pak shpenzime;
- 6) përparësisë, sipas së cilës në rast të ekzistimit të konfliktit të interesave lidhur me regjistrimin e të dhënës në regjistër, përparësi ka fletëparaqitja e parashtruar më herët për regjistrim;
- 7) profesionalizimit, sipas të cilit regjistruesi dhe personat e tjerë regjistrimet i kryejnë me nivel të lartë të profesionalizimit dhe etikës profesionale; dhe
- 8) unitetit në regjistrimin e të dhënave gjatë regjistrimit, sipas të cilit gjatë parashtrimit të fletëparaqitjes për regjistrim, njëkohësisht regjistrohen të gjitha të dhënat nga fletëparaqitja për regjistrim.

Kompetenca për udhëheqjen e regjistrave

Neni 17

- (1) Regjistrin tregtar dhe regjistrin e personave të tjerë juridikë, i udhëheq Regjistri qendror përmes zyrave të regjistrimit.
- (2) Regjistri qendror me aktin e tij i përcakton komunat në të cilat i hap zyrat nga paragrafi (1) të këtij neni.
- (3) Akti nga paragrafi (2) të këtij neni, shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe është i kapshëm në ueb faqen e Regjistrit qendror.

Regjistruesi

Neni 18

- (1) Regjistruesin me propozimin e drejtorit të Regjistrit qendror, e emëron Këshilli drejtues i Regjistrit qendror.
- (2) Regjistruesi emërohet nga radhët e juristëve të diplomuar me provimin e dhënë të jurisprudencës dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet në punë juridike pas dhënies së provimit. Emërimi bëhet në bazë të shpalljes publike për periudhën prej katër vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje.
- (3) Me propozimin e drejtorit të Regjistrit qendror, Këshilli drejtues i Regjistrit qendror, mund ta shkarkojë regjistruesin para skadimit të kohës për të cilën është emëruar, si vijon:
 - 1) me kërkesën e regjistruesit,
 - 2) nëse regjistruesi nuk e kryen funksionin e vet në pajtim me ligjin dhe aktet e Regjistrit qendror, pas procedurës së zbatuar paraprakisht dhe gjendjes faktike të konfirmuar,
 - 3) nëse është dënuar për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj ose i është shqiptuar masa e sigurisë ndalim për kryerjen e funksionit, veprimtarisë ose detyrës, në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj,
 - 4) në rast të pengimit për kryerjen e funksionit për shkak të sëmundjes më gjatë se gjashtë muaj,
 - 5) keqpërdorimit të funksionit.

Autorizimet dhe obligimet e regjistruesit

Neni 19

(1) Regjistruesi i ka obligimet dhe autorizimet si vijojnë:

- 1) kryen regjistrimin në regjistrin përkatës sipas procedurës së përcaktuar me ligj, lëshon vërtetime për fletëparaqitjen e parashtruar për regjistrim dhe merr vendime sipas fletëparaqitjes së parashtruar për regjistrim;
- 2) siguron inspektim në regjistrin përkatës, lëshon ekstraktin e vërtetuar të regjistrimit dhe kopje të dokumenteve dhe dëshmime të subjekteve të regjistrimit në bazë të së cilave është kryer regjistrimi në regjistër;
- 3) kujdeset që formularët për regjistrim në regjistër të jenë të kapshëm për subjektet në regjistrim në formë të shkruar dhe përmes ueb faqes së Regjistrit qendror;
- 4) siguron bartjen nga forma e shkruar në formë elektronike të dokumenteve dhe dëshmime të subjekteve në regjistrim në bazë të së cilave është kryer regjistrimi në regjistër;
- 5) kujdeset për ruajtjen e të gjitha dokumenteve dhe dëshmime të subjekteve në regjistrim në bazë të së cilave është kryer regjistrimi në regjistër; dhe
- 6) kujdeset edhe për punë të tjera të nevojshme për funksionimin e rregullt dhe pa pengesa të regjistrave në pajtim me ligjin dhe dispozitat e aktet e tjera të Regjistrit qendror.

(2) Regjistruesi punët nga paragrafi (1) të këtij neni i kryen në pajtim me ligjin, punon sistematikisht, me azhurnim i udhëheq regjistrat dhe sillet në mënyrë profesionale ndaj personave që kërkojnë regjistrim dhe inspektim në regjistrat.

Shmangia e regjistrit

Neni 19-a

(1) Sipas kërkesës për shmangien e regjistrit vendos drejtori i Regjistrit qendror me konkluzion.

(2) Me konkluzionin me të cilin është miratuar kërkesa për shmangie, do të caktohet person tjetër i autorizuar i cili do të vendosë në procedurën lidhur me lëndën në të cilën është përcaktuar shmangia.

Personat e autorizuar

Neni 20

(1) Regjistruesi autorizimet e veta nga neni 19 të këtij ligji i kryen përmes personave të autorizuar në Zyrat e regjistrimit.

(2) Personat nga paragrafi (1) të këtij neni i emëron drejtori i Regjistrit qendror me propozimin e Regjistruesit.

(3) Personat nga paragrafi (1) të këtij neni janë juristë të diplomuar, të cilët paraprakisht e kanë dhënë provimin e jurisprudence.

(4) Provimi profesional realizohet përmes Programit për dhënien e provimit profesional, të cilin me propozimin e Regjistruesit e miraton Këshilli drejtues i Regjistrit qendror. Provimi jepet para Komisionit që e formon drejtori i Regjistrit qendror, nga personat prej të cilëve shumica janë persona të papunësuar në Regjistrin qendror. Puna e Komisionit dhe çështje të tjera nga kompetenca e tij, rregullohen me Rregulloren e punës.

Të dhënat të cilat regjistrohen

Neni 21

(1) Regjistri i përmban të dhënat të cilat me ligj janë përcaktuar se regjistrohen në regjistër.

(2) Në regjistër futen edhe të dhënat që janë me rëndësi për kryerjen e veprimtarisë së subjektit të regjistrimit, si regjistrimi i numrit të ndarë të obliguesit të TVSH-së, licencat, lejet e veçanta, koncesionet e ngjashëm, e të cilat me ligj janë përcaktuar që të regjistrohen në regjistra dhe evidenca të veçanta. Këto të dhëna evidentohen në formë elektronike.

(3) Përveç të dhënave nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, me kërkesën e subjektit të regjistrimit, në regjistër mund të regjistrohen edhe informatat për numrin e telefonit, numrin e faksit, adresën e ueb faqes dhe të dhëna të tjera për subjektin e regjistrimit të përmbajtura si opsione në fletëparaqitje.

(4) Në procedurë për regjistrim në regjistrin kompetent, subjektet e regjistrimit përveç të dhënave të përcaktuara në paragrafin (2) të këtij neni, detyrohen që ta paraqesin për regjistrim edhe adresën e postës elektronike për pranimin e dokumenteve, si dhe çdo ndryshim në adresë të kutisë elektronike.

Pjesa përbërëse e regjistrave

Neni 22

(1) Kur kjo është përcaktuar me ligj, regjistri përmban edhe përmbledhje të shtojcave në të cilën bashkëngjiten dokumentet dhe dëshmitë (në tekstin e mëtejme: shtojcat) e ndonjë subjekti të regjistrimit në bazë të së cilave është kryer regjistrimi në regjistër.

(2) Shtojcat nga paragrafi (1) të këtij neni mund të paraqiten në formë elektronike.

(3) Shtojcat nga paragrafi (1) të këtij neni dhe fletëparaqitja nëse janë parashtruar në formë të shkruar, pas dërgimit dhe kalimit të tyre në formë elektronike, do të arkivohen dhe ruhen përherë në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohet lënda arkivore.

Formularët e regjistrimit

Neni 23

(1) Regjistrimet në regjistër kryhen në formularë të veçantë.

(2) Formularët për regjistrim i përgatit Regjistri qendror dhe ata e përcjellin zgjidhjen sistemore të regjistrimit përkatës. Formën dhe përmbajtjen e formularëve i përcakton ministri i Ekonomisë. Formularët për regjistrim janë të kapshëm edhe në formë elektronike për parashtrimin e tyre në formë elektronike nëpërmjet sistemit njësportel.

Formulari për ndarjen e të hyrave sipas veprimtarive

Neni 23-a

(1) Formulari për ndarjen e të hyrave të realizuara sipas veprimtarive nga neni 9 i këtij ligji është pjesë përbërëse e llogarisë vjetore dhe i raporteve financiare të subjektit. Afati për përgatitjen dhe dërgimin e Formularit për

ndarjen e të hyrave të realizuara sipas veprimtarive është identik me afatet për përgatitjen dhe dërgimin e llogarive vjetore dhe raporteve financiare të cilat i dorëzohen Regjistrorit qendror në pajtim me dispozitat e Ligjit për shoqatat tregtare.

(2) Ministri i Financave e përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e plotësimit të Formularit për ndarjen e të hyrave të realizuara sipas veprimtarive.

(3) Ministri i Financave do të përcaktojë se cilat të dhëna të veçanta janë të nevojshme për sistemin e evidencës shtetërore dhe do ta përcaktojë formën dhe përmbajtjen e formularit të evidencës shtetërore.

Deklarata për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në llogarinë vjetore dhe raportet financiare

Neni 23-b

(1) Në shtojcë të secilës llogari vjetore dhe raporteve financiare të dorëzuara në formë të letrës dorëzohet Deklaratë e nënshkruar nga përfaqësuesi me ligj, të dhënë nën përgjegjësinë penale, materiale dhe morale për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në llogarinë vjetore dhe raportet financiare, e kur llogaria vjetore dhe raportet financiare parashtrihen në formë elektronike, deklarata që është pjesë përbërëse e tyre nënshkruhet me nënshkrim elektronik.

Ndërrimi i të dhënave të regjistruara

Neni 24

(1) Subjekti i regjistrimit që ka kërkuar regjistrim në regjistër, mund të kërkojë që të ndërrohet, plotësohet, azhurnohet dhe të fshihet e dhëna e regjistrimit të kryer në regjistër, ose të bëhet ndryshimi ose plotësimi i shtojcave.

(2) Regjistruesi ndërron, plotëson, azhurnon ose fshin të dhënë e regjistrimit të kryer në regjistër dhe sipas vendimit të plotfuqishëm.

Shfrytëzimi dhe qasja e të dhënave

Neni 25

(1) Të dhënat nga regjistrimet e kryera në regjistra sipas ligjit, mund t'i shfrytëzojnë të gjithë personat juridikë e fizikë në mënyrën e përcaktuar me Ligjin për regjistrin qendror, përkatësisht me ligj tjetër.

(2) Regjistri qendror siguron qasjen e përhershme të të dhënave të regjistruara në regjistra përmes ueb faqes së vet.

2. UDHËHEQJA E REGJISTRAVE NË FORMË ELEKTRONIKE

Udhëheqja elektronike e regjistrave

Neni 26

Vendosjen, udhëheqjen dhe administrimin e regjistrave në formë elektronike, Regjistri qendror e kryen në mënyrë dhe procedurë me të cilën sigurohet njëjtësia e regjistrat në formë të shkruar dhe elektronike, si dhe uniteti, objektiviteti, siguria, racionaliteti, funksionaliteti dhe transparenca.

Zgjidhja elektronike e udhëheqjes së regjistrave

Neni 27

(1) Regjistri qendror përgatit zgjidhjen elektronike për udhëheqjen e të gjitha llojeve të regjistrimeve në regjistrat në formë elektronike sipas orarit kronologjik. Zgjidhja elektronike siguron qasjen e kontrolluar rreptë vetëm për personat e autorizuar të sistemi, të paraqitur në Regjistrin qendror me emrin e vet të përdorimit dhe parullën.

(2) Regjistri qendror garanton sigurinë dhe mbrojtje e të dhënave që i udhëheq në formë elektronike, përmes masave të mbrojtjes fizike dhe sistemit për ruajtjen e dyfishtë të të dhënave.

Të dhënat që ruhen në regjistrat në formë elektronike

Neni 28

(1) Në regjistrat në formë elektronike në mënyrë përkatëse futen dhe ruhen fletëparaqitja e regjistrimit të subjektit të regjistrimit, shtojcat (dokumentet dhe dëshmitë), vendimet e marra nga gjyqi lidhur me regjistrimin në regjistrat dhe shkresat e tjera.

(2) Në regjistrat në formë elektronike, futet dhe ruhet përmbajtja e tërësishme e regjistrave që udhëhiqet në formë të shkruar.

Protokolli elektronik

Neni 29

(1) Për udhëheqjen e regjistrave në formë elektronike shfrytëzohet protokoli elektronik.

(2) Përmbajtja e protokollit elektronik përcaktohet me dispozitën nga neni 23 të këtij Ligji.

Aktvendimi për regjistrim në regjistër

Neni 30

(1) Pas futjes, kontrollit dhe miratimit të të dhënave në formularin elektronik, të dhënat që futen në regjistër shtypen në mënyrë automatike.

(2) Aktvendimi për regjistrim në regjistër merret në formular përkatës për llojin e regjistrimit, sipas të dhënave nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Aktvendimi për regjistrim i përmban të dhënat vijuese për subjektin e regjistrimit në regjistër.

(4) Aktvendimi i miratuar për regjistrim është i kapshëm për subjektin e regjistrimit në formë elektronike në rast kur parashtrimi i fletëparaqitjes për regjistrim kryhet në formë elektronike nëpërmjet internetit. Me

kërkesë të parashtruesit të autorizuar aktvendimi mund t'i dorëzohet subjektit të regjistrimit edhe me shkrim.

Arritja dhe shfrytëzimi i të dhënave të regjistruara në regjistër në formë elektronike

Neni 31

- (1) Të dhënat e regjistruara në regjistër në formë elektronike janë publike dhe të arritshme sipas kushteve të përcaktuara me këtë ose ligj tjetër.
- (2) Të dhënat e regjistruara në regjistër në formë elektronike me shpenzimet e paraqitësit të kërkesës, botohen në formë të informatës, vërtetimit, kopjes së shkresave të skanuara dhe ngjashëm.
- (3) Kundër të dhënave të lëshuara në lloj të informatës, vërtetimi, kopje shkresa e skanuar, pala mund të parashtrojë kundërshtim. Kundërshtimi parashtrohet deri te Regjistri Qendror në afat prej tetë ditë nga dita e pranimit të informacionit, vërtetim respektivisht kopje nga shkresa e skanuar.
- (4) Për kundërshtimin vendos pjesë e veçantë organizative e Regjistrimit Qendror.
- (5) Vendimi për kundërshtimin sillet nga ana e Regjistrimit Qendror, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kundërshtimit.
- (6) Kundër vendimit nga paragrafi (5) të këtij neni, mund të ngritet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

3. PROCEDURA PËR REGJISTRIMIN NË REGJISTËR

Ngritja e procedurës

Neni 32

Procedura për regjistrim në regjistër ngrihet me parashtrimin e fletëparaqitjes për regjistrim me shkrim në zyrën e Regjistrimit Qendror, ose me parashtrimin e fletëparaqitjes për regjistrim në formë elektronike nëpërmjet sistemit njësportel, nëse me ligj tjetër nuk është rregulluar ndryshe.

Përmbajtja e fletëparaqitjes për regjistrim

Neni 33

- (1) Fletëparaqitja për regjistrim parashtrohet në formular të përcaktuar, i cili i përmban të dhënat që regjistrohen në regjistrin adekuat në pajtim me ligjin. Nëse nuk është përcaktuar formulari, fletëparaqitja për regjistrim parashtrohet si shkresë në të cilën shënohen të dhënat, të cilat sipas ligjit regjistrohen në regjistër.
- (2) Fletëparaqitjes për regjistrim i bashkëngjiten shtojcat e përcaktuara me ligj sipas llojit të regjistrimit, përkatësisht të së dhënës që regjistrohet në regjistër dhe dëshmisë për kompensimin e arkëtuar të shpenzimeve.

(3) Regjistri Qendror nëpërmjet sistemit njësportel mundëson që të gjithë parashtruesit e fletëparaqitjeve për regjistrim në regjistrin tregtar, të cilët parashtrimin e bëjnë në formë elektronike jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë, ta përdorin opsionin e përkrahjes gjuhësore të gjuhës tjetër zyrtare të vendit anëtar të Unionit Evropian që i përgjigjet përkrahjes maqedonase për të njëjtën zgjidhje.

Parashtruesi i fletëparaqitjes

Neni 34

Parashtruesi i fletëparaqitjes është person i cili është i autorizuar me ligj të parashtrojë fletëparaqitje për regjistrim.

(2) Fletëparaqitja për regjistrim në formë elektronike në emër të parashtruesit nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të parashtrohet edhe nga agjenti regjistruar.

Kritere për marrjen e autorizimit agjent regjistruar

Neni 34-a

(1) Për marrjen e autorizimit për agjent regjistruar, personi duhet t'i përmbush kriteret në vijim:

1) të jetë i regjistruar si individ tregtar apo shoqëri tregtare për kryerjen e veprimtarisë së kontabilitetit, apo të jetë i regjistruar në Listën e emrave të avokatëve, apo Listën e shoqërive të avokatëve;

2) të ketë person të punësuar me certifikatë për kontabilist/kontabilist të autorizuar në pajtim me Ligjin për kryerje të punëve të kontabilitetit, apo të jetë kryerës i veprimtarisë së avokatit në pajtim me Ligjin për avokati;

3) të përmbush kushte të caktuara teknike-teknologjike dhe pajisje përkatëse për realizimin e autorizimit, të ketë marrëveshje të nënshkruar për shfrytëzim të Sistemit për e-regjistrim me Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë dhe të posedojë certifikatë digjitale të kualifikuar personale, në pajtim me Ligjin për të dhëna në formë elektronike dhe nënshkrim elektronik dhe

4) të ketë deklaratë të nënshkruar për mbrojtjen e të dhënave personale para fillimit të punës dhe se do t'i respektojë rregullat për parashtrimin e fletëparaqitjes për regjistrim të caktuara me ligj.

(2) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë i përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të autorizimit nga neni 35 paragrafi 3 i këtij ligji.

Shpenzimet për marrjen e autorizimit

Neni 34-b

(1) Shpenzimet për marrjen e autorizimit i bartë kërkuesi.

(2) Shpenzimet nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton Regjistri Qendror.

Procedura për marrjen e autorizimit

Neni 34-v

(1) Për marrjen e autorizimit, personi parashtron kërkesë te Regjistri Qendror.

(2) Me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, bashkëngjitet:

- 1) dëshmia për persona të punësuar me certifikatë për kontabilist/kontabilist i autorizuar, kur bëhet fjalë për tregtar individ apo shoqëri tregtare për kryerjen e punëve të kontabilitetit;
- 2) deklaratë se plotëson kushte të caktuara teknike teknologjike dhe pajisje përkatëse për realizimin e autorizimit dhe certifikatë digjitale personale të kualifikuar, në pajtim me Ligjin për të dhëna në formë elektronike dhe nënshkrim elektronik dhe
- 3) deklarata për mbrojtjen e të dhënave personale e nënshkruar nga kërkuesi i autorizimit dhe se do t'i respektojë rregullat për parashtrimin e fletëparaqitjes për regjistrim të caktuara me ligj.

(3) Kërkesa nga paragrafi (2) i këtij neni parashtrohet në dy formularë identikë me një shtojcë të dëshmive.

(4) Regjistri Qendror i përcakton formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara me këtë ligj, Regjistri Qendror me personin nga paragrafi (1) i këtij neni, nënshkruan marrëveshje për shfrytëzimin e Sistemit për e-regjistrim dhe në afat prej 15 ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton aktvendim për autorizim të agjentit të regjistrimit.

(6) Aktvendimi nga paragrafi (4) i këtij ligji, lëshohet me vlefshmëri të përhershme.

(7) Autorizimi nuk mund të bartet.

Refuzimi i kërkesës

Neni 34-g

(1) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i kërkesës nga neni 34-v paragrafi (1) i këtij ligji, me aktvendim do ta refuzojë të njëjtën nëse nuk janë përmbushur kriteret e caktuara me këtë ligj.

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktvendimit, te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Heqja e autorizimit

Neni 34-d

(1) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë me aktvendim do ta heq autorizimin për agjentin regjistruar në rastet kur bartësi i autorizimit do të pushojë të përmbushë njërin nga kriteret e përcaktuara në pajtim me nenin 34-a paragrafi (1) të këtij ligji, si dhe në rast kur bartësi i autorizimit:

- 1) nuk i respekton rregullat për parashtrimin e fletëparaqitjes për regjistrim të caktuara me ligj;
- 2) në afat prej gjashtë muajsh nuk parashtron asnjë fletëparaqitje për regjistrim apo
- 3) do të japë deklaratë se nuk dëshiron ta ushtrojë veprimtarinë e agjentit regjistruar.
- 4) nëse në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të procesverbalit nga neni

34-z paragrafi (4) të këtij ligji nuk i largon mungesat e konstatuara në të njëjtën dhe për atë e njofton personin autorizuar zyrtar.

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni mund të paraqitet ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

(3) Ankesa kundër vendimit nga paragrafi (2) të këtij neni nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

(4) Subjektit të cilit i është hequr autorizimi për agjent regjistruar do të mund sërish të marrë autorizim të ri për agjent regjistruar pas kalimit të afatit prej një viti nga heqja e autorizimit.

Kontrolli i agjentit regjistruar

Neni 34-gj

(1) Regjistri Qendror kryen kontroll mbi bartësin e autorizimit të agjentit të regjistrimit, në lidhje me përmbushjen e kriterëve për marrjen e autorizimit, veprimi gjatë paraqitjes së regjistrimit të shërbimeve nëpërmjet Sistemit e-regjistrim.

(2) Kontrolli nga paragrafi (1) të këtij neni do të zbatohet sipas detyrës zyrtare ose pas parashtrimit paraprak të kallëzimit, me njoftim paraprak ose pa paralajmërim. Kontrolli zbatohet në terren nëpërmjet kontrollit të drejtpërdrejtë në hapësirat e bartësit të autorizimit dhe përmes evidentimit të të dhënave të regjistruara në regjistrat.

(3) Regjistri Qendror do të përgatisë plan vjetor për kontrollin dhe në ueb faqen e saj publikon lista të subjekteve që do të jenë lëndë e kontrollit dhe afatit kohor brenda periudhën kohore në të cilën do të zbatohet e njëjta. Në mënyrë plotësuese, subjektet objekt i kontrollit i informon edhe përmes evidentimit të adresës së evidentuar të kutisë postare elektronike .

Neni 34-e

(1) Kontrolli i drejtpërdrejtë i terrenit e përfshin kontrollin:

- e njëjtësisë së të dhënave të paraqitjes dhe shtesa të parashtruara përmes sistemit për e-regjistrim me të dhëna të përmbajtura në shtesat dorëzuar deri te agjenti regjistruar nga subjekti i regjistrimit,
- plotësimin e kriterëve të përcaktuar me nenin 34-a nga ky ligj,
- nëse për shërbimin e kryer për parashtrimin e paraqitjes për regjistrim për themelimin tregtarit individual dhe shoqëria tregtare vepron në pajtim me nenin 35 paragrafi (7) të këtij ligji dhe
- në veprimin në pajtim me nenin 82 paragrafi (4) nga

Ligji për shoqëri tregtare.

Neni 34-zh

(1) Kontrollin e drejtpërdrejtë i terrenit e zbatojë persona zyrtar të punësuar në Regjistrin Qendror, të autorizuar nga drejtori i Regjistrin Qendror.

Neni 34-z

- (1) Agjentët regjistruar janë të obliguar personit të autorizuar zyrtar nga neni 34-zh nga ky ligj, t'i sigurojnë kushte për zbatimin e kontrollit, si dhe t'i mundësohet kontroll në dokumentet e nevojshme dhe të dhënat.
- (2) Për kontrollin e kryer, personi i autorizuar zyrtar përpilon procesverbal në të cilën evidentohet gjendja faktike e përcaktuar. Procesverbalin e nënshkruan personi i autorizuar zyrtar dhe agjenti i kontrolluar regjistruar.
- (3) Nëse agjenti regjistruar refuzon ta nënshkruajë dhe të pranojë procesverbal, refuzimi nuk është me rëndësi për ngritjen e procedurës për heqjen e autorizimit.
- (4) Nëse gjatë zbatimit të kontrollit konstatohet mosplotësimi i kriterëve të parapara në nenin 34-a të këtij ligji, ose mosveprimin në pajtim me nenin 82 paragrafi (4) nga ligji për shoqëri tregtare, persona të autorizuar zyrtar me procesverbal e ngarkon agjentin regjistruar në afat prej 15 ditë t'i largon mangësitë e konstatuara.
- (5) Personi i autorizuar zyrtar nëse konstaton shkelje të nenit 35 paragrafi (7) të këtij ligji, në procesverbalin do të konstatojë se do të zbatohet procedurë për miratimin e vendimit për heqjen e autorizimit të agjentit regjistruar të autorizuar.
- (6) Ekzemplar nga procesverbal nga paragrafi (2) të këtij neni, personi i autorizuar zyrtar dorëzon te subjekti i kontrolluar nga dita e zbatimit të kontrollit.

Parashtrimi i fletëparaqitjes

Neni 35

- (1) Fletëparaqitje për regjistrim parashtrohet në formë në letër apo në formë elektronike. Kur fletëparaqitja parashtrohet në formë elektronike nënshkruhet me nënshkrim elektronik.
- (2) Fletëparaqitja për regjistrim të tregtarit individ dhe shoqërisë tregtare në regjistrim tregtar unik parashtrohet ekskluzivisht në formë elektronike.
- (3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, fletëparaqitja për regjistrim parashtrohet në formë në letër kur regjistrimi bëhet në bazë të vendimit të plotfuqishëm gjyqësor, apo vendimit të organit të administratës shtetërore.
- (4) Fletëparaqitja për regjistrim në formë në letër parashtrohet në një ekzemplar, në njërin nga zyrat e regjistrimit të Regjistrimit Qendror të Republikës së Maqedonisë.
- (5) Fletëparaqitja për regjistrim në formë elektronike parashtrohet përmes Sistemit për e-regjistrim.
- (6) Nëse fletëparaqitja për regjistrim parashtrohet në formë në letër përmes postës, si datë dhe kohë e parashtrimit të saj konsiderohet data dhe koha e pranimit në zyrën për regjistrim.
- (7) *I shfuqizuar* 3

Neni 35-a

- (1) Shtojcat të cilat në mënyrë burimore janë përpiluar në formë elektronike nga parashtruesi nga neni 34 paragrafi (2) të këtij ligji dhe të

nënshkruara nga ai me nënshkrim elektronik e kanë rëndësinë e origjinalit.

(2) Parashtruesi nga neni 34 paragrafi (2) të këtij ligji, shtojcat e fletëparaqitjes për regjistrim që janë përpiluar në letër, doemos duhet t'i konvertojnë, respektivisht t'i bartë si tërësi në formë elektronike.

(3) Shtojcat nga paragrafi (2) i këtij neni, të nënshkruara me nënshkrim elektronik të parashtruesit nga neni 34 paragrafi (2) të këtij ligji, e kanë rëndësinë e përshkrimit të verifikuar nga origjinali.

Neni 35-b

(1) Agjenti regjistruar tregtar individ dhe shoqëri tregtare, si kontabilist/kontabilist i autorizuar, kryejnë parashtrim elektronik të fletëparaqitjeve për regjistrim të themelimit të tregtarit individ, shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të një personi.

(2) Agjenti regjistruar avokat individ apo shoqëri e avokatëve kryejnë parashtrim elektronik të fletëparaqitjes për regjistrim të tregtarit individ, fletëparaqitjes për regjistrim të themelimit, ndryshimit dhe shlyerjes së të gjitha formave të shoqërisë tregtare të caktuara me Ligjin për shoqëri tregtare në regjistrin tregtar unik.

(3) Agjenti regjistruar nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni e përcakton identitetin e pjesëmarrësve në procedurën për regjistrim, vërtetësinë e nënshkrimeve të shtojcave ndaj fletëparaqitjes për regjistrim dhe këto i verifikon me nënshkrim të vet digjital.

(4) Identiteti i pjesëmarrësve përcaktohet në bazë të letërnjoftimit të vlefshëm apo dokumentit të udhëtimit, kurse për personat juridikë në bazë të provës për regjistrim në regjistrin kompetent, kurse vërtetësia e nënshkrimit përcaktohet në bazë të deklaratës personale me të cilën nënshkrimi pranohet si i tij apo me nënshkrim me dorën e vet të shtojcave në prezencën e agjentit regjistruar.

Vërtetimi për fletëparaqitjen e parashtruar për regjistrim

Neni 36

(1) Pas evidentimit të fletëparaqitjes për regjistrim në protokollarin elektronik, automatikisht ndahet numri i protokollit dhe jepet vërtetimi për pranim.

(2) Vërtetimi jepet në formular të përcaktuar me dispozitën nga neni 23 të këtij ligji, me shënimin e kohës së parashtrimit të fletëparaqitjes për regjistrim, numrin me të cilin është regjistruar në protokollarin elektronik, shenjën e regjistrimit, lëndën e regjistrimit, listën e shtojcave të pranuar dhe e dhëna për lartësinë e kompensimit të arkëtuar për regjistrim.

(3) Nëse fletëparaqitja për regjistrim është parashtruar në formë elektronike ose me postë, vërtetimi pa shtyrje, i dërgohet parashtruesit të fletëparaqitjes për regjistrim në adresën postare ose elektronike të shënuar në fletëparaqitjen për regjistrim.

Tërheqja e fletëparaqitjes

Neni 37

(1) Parashtruesi i fletëparaqitjes për regjistrim fletëparaqitjen mund ta tërheqë deri në marrjen e aktvendimit të shkallës së parë.

(2) Nëse fletëparaqitja është tërhequr, do të merret konkluzion për ndërprerjen e procedurës.

Veprimi sipas fletëparaqitjes me mangësi

Neni 38

(1) Nëse fletëparaqitja përmban mangësi formale që e pengon veprimin sipas fletëparaqitjes dhe vetëm për shkak të saj nuk mund të hidhet, regjistruesi për këtë do ta informojë parashtruesin në afat prej 5 (pesë) ditësh që t'i mënjanojë mangësitë. Për informimin, regjistruesi do të shënojë vërejtje në fletëparaqitje.

(2) Nëse parashtruesi i mënjanon mangësitë në afatin nga paragrafi 1 të këtij neni, do të konsiderohet se fletëparaqitja është parashtruar në rregull. Nëse parashtruesi nuk i mënjanon mangësitë në afatin e përcaktuar, do të konsiderohet se fletëparaqitja nuk është parashtruar, për çka regjistruesi do të miratuar konkluzion kundër të cilit mund të paraqitet ankesë e veçantë. Për këtë pasojë parashtruesi i fletëparaqitjes do të paralajmërohet në informimin për korrigjimin e fletëparaqitjes.

(3) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes, i mënjanon mangësitë e konstatuara të fletëparaqitjes për regjistrim, mban të drejtën e përparësisë së fletëparaqitjes së parashtruar më parë për regjistrim.

Shqyrtimi i fletëparaqitjes

Neni 39

(1) Pas pranimit të fletëparaqitjes për regjistrim, regjistruesi kontrollon nëse:

- 1) Regjistri qendror është kompetent të veprojë sipas fletëparaqitjes;
- 2) janë plotësuar kushtet për regjistrim të përcaktuara me ligj;
- 3) nënshkruesi i fletëparaqitjes është personi i autorizuar për paraqitjen e saj;
- 4) fletëparaqitja për regjistrim i përmban të gjitha të dhënat në pajtim me ligjin;
- 5) fletëparaqitjes për regjistrim i janë bashkangjitur të gjitha shtojcat e përcaktuara me ligj;
- 6) të dhënat e shënuara në fletëparaqitjen për regjistrim janë të njëjtat si edhe të dhënat në shtojcat me fletëparaqitjen;
- 7) me të njëjtën firmë, përkatësisht emër është regjistruar subjekt tjetër në regjistrim; dhe
- 8) fletëparaqitjes për regjistrim i është bashkangjitur dëshmia për kompensimin e arkëtuar për regjistrimin.

(2) Gjatë regjistrimit regjistruesi:

- 1) nuk e kontrollon ligjshmërinë dhe vërtetësinë e përmbajtjes së shtojcave (dokumenteve dhe dëshmive) të cilat paraqiten gjatë regjistrimit në regjistër;
- 2) nuk e kontrollon ligjshmërinë e procedurës në të cilat ato janë miratuar;
- 3) nuk kontrollon se të dhënat të cilat regjistrohen në regjistër a janë të vërteta dhe në pajtim me ligjin.

(3) Për vërtetësinë dhe ligjshmërinë e shtojcave dhe të dhënave nga paragrafi (2) përgjigjet personi, përkatësisht personat e përcaktuar me ligj.

Më shumë kërkesa me një fletëparaqitje

Neni 40

(1) Regjistruesi njëkohësisht vendos sipas kërkesës për regjistrim në regjistrin e të gjitha të dhënave, të cilat janë përfshirë në fletëparaqitjen për regjistrim.

(2) Nëse në fletëparaqitjen për regjistrim janë theksuar më shumë kërkesa për regjistrimin e ndryshimin e të dhënave të regjistruara në regjistër, mund të merren aktvendime të ndryshme për kërkesa të veçanta.

Vendimi për regjistrim

Neni 41

(1) Nëse regjistruesi konstaton se janë plotësuar kushtet për regjistrim në pajtim me nenin 39 nga ky ligj, në afat prej katër orë nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit të kompletuar, do të marrë aktvendim për regjistrim.

(2) Aktvendimi për regjistrim në regjistër merret pa arsyetim.

(3) Kur fletëparaqitja për regjistrim parashtrohet në formë elektronike, afati nga paragrafi (1) të këtij neni llogaritet nga dita e pranimit të fletëparaqitjes dhe shtojcave me fletëparaqitjen në formë të shkruar.

(4) Aktvendimi për regjistrim përmbahet me ditën e marrjes së tij.

(5) Ankesa kundër aktvendimit nga paragrafi (1) të këtij neni, nuk e shtyn përmbahimin e aktvendimit.

(6) Parashënimi i të dhënave, për të cilat është përcaktuar me ligj, bëhet me konkluzion me të cilin konstatohet parashënimi i të dhënave.

Neni 41-a

(1) Nëse regjistri nuk e miraton aktvendimin nga neni 41 paragrafi (1) i këtij ligji, përkatësisht nuk e refuzon fletëparaqitjen për regjistrim në afatin nga neni 41 paragrafi (1) i këtij ligji, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditësh pune të parashtrojë kërkesë në sekretarinë e drejtorit të Regjistrit qendror për miratimin e aktvendimit për kërkesën e parashtruar.

(2) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni i përcakton ministri i Ekonomisë.

(3) Me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni parashtruesi i kërkesës dorëzon edhe kopje të kërkesës nga neni 32 i këtij ligji.

(4) Drejtori i Regjistrit qendror ka për detyrë që në afat prej pesë ditësh pune nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni në sekretarinë e Drejtorit të Regjistrit qendror të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa për regjistrimin e të dhënave në regjistër është pranuar ose

refuzuar. Nëse Drejtori i Regjistrimit qendror nuk ka sekretari, kërkesa parashtrëhet në sekretarinë e selisë së Regjistrimit qendror.

(5) Nëse Drejtori i Regjistrimit qendror nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Administrativ Shtetëror në afat prej pesë ditësh pune.

(6) Inspektori ka për detyrë që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni të kryejë mbikëqyrje në Regjistrin qendror nëse është zbatuar procedura në pajtim me këtë ligj dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes ta njoftojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(7) Inspektori pas kryerjes së mbikëqyrjes në pajtim me ligj miraton aktvendim me të cilin e obligon Drejtorin e Regjistrimit qendror që në afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e parashtruar, përkatësisht ta miratojë ose ta refuzojë kërkesën, dhe ta njoftojë Inspektoratin Administrativ Shtetëror dhe t'i dorëzojë kopje nga akti me të cilin është vendosur për kërkesën.

(8) Nëse drejtori i Regjistrimit qendror nuk vendos në afatin nga paragrafi (7) i këtij neni, Inspektori do të parashtrëjë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune, në të cilin drejtori i Regjistrimit qendror do të vendosë për kërkesën e parashtruar për çka në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditësh pune e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(9) Nëse drejtori i Regjistrimit qendror nuk vendos edhe në afatin plotësues nga paragrafi (8) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditësh pune do t'i parashtrëjë fletëparaqitje prokurorit publik kompetent dhe në atë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(10) Nëse inspektori nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi (6) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditësh pune ka të drejtë të parashtrëjë kundërshtim për sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Administrativ Shtetëror. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrëhet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Administrativ Shtetëror.

(11) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ ka për detyrë që në afat prej tri ditësh pune nga dita e pranimit, ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (10) i këtij neni, dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar sipas njoftimit të parashtruesit të kërkesës nga paragrafi (5) i këtij neni, ose nuk ka parashtruar fletëparaqitje në pajtim me paragrafin (9) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtrëjë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin, dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në Regjistrin qendror nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(12) Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi (11) i këtij neni, Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do t'i parashtrëjë fletëparaqitje prokurorit publik kompetent kundër inspektorit, dhe në afat prej tre dite pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës.

(13) Në rast të paragrafit (12) të këtij neni drejtori i Inspektoratit Administrativ Shtetëror, menjëherë, e më së voni në afat nga një dite pune, do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(14) Në rast të paragrafit (13) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditësh e informon parashtruesin e kërkesës për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ.

(15) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (11) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund t'i parashtrojë fletëparaqitje prokurorit publik kompetent në afat prej tetë ditësh pune.

(16) Nëse drejtori i Regjistrit qendror nuk vendos në afatin nga paragrafi (9) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngrejë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(17) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

(18) Akti nënligjor nga paragrafi (2) i këtij neni miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të këtij ligji.

(19) Pas miratimit të aktit nënligjor nga paragrafi (2) i këtij neni ai menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh shpallet në ueb faqen e Regjistrit qendror.

Dërgimi i vendimit

Neni 42

(1) Regjistri qendror, pas futjes së të dhënave nga neni 4 të këtij ligji, aktvendimin për regjistrim ia dërgon subjektit të regjistrimit dhe subjekteve tjera kur kjo është përcaktuar me ligj.

(2) Aktvendimi për regjistrim nga paragrafi (1) i këtij neni dërgohet pa shtyrje pas dëshmisë paraprakisht të dërguar për kompensimin e arkëtuar të shpenzimeve të Regjistrit qendror.

(3) Data e pranimit të aktvendimit shënohet në aktvendim në formë të shkruar dhe futet në aktvendim në formë elektronike.

(4) Aktvendimi i miratuar në procedurën e parashtrimit elektronik të dokumenteve për regjistrim në regjistër, konsiderohet i dorëzuar kur i njëjti do të publikohet në faqen zyrtare të internetit, të Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë.

(5) Regjistri Qendror detyrohet që të dorëzojë ekzemplarë nga aktvendimin i përcaktuar në paragrafin (4) të këtij neni, në adresën e postës elektronike të subjektit të regjistrimit për të cilin është miratuar aktvendimi.

Korrigjimi i gabimeve

Neni 43

(1) Nëse ndërmjet të dhënave të regjistruara në regjistër dhe të dhënave të regjistruara në aktvendim ekziston mospajtim sa u përket emrave ose numrave, të shkrimit ose llogarisë, si dhe gabime tjera të dukshme në

aktvendim ose në kopjet tjera të vërtetuara të tij, regjistruesi i cili e ka nënshkruar ose dhënë aktvendimin në çdo kohë mund t'i korrigjojë gabimet. Korrigjimi i gabimeve prodhon veprim juridik nga dita prej të cilës prodhon veprim juridik aktvendimi që korrigjohet, kurse për persona të tretë nga dita e ardhshme nga shpallja e korrigjimit.

(2) Për korrigjimin miratohet konkluzion i veçantë. Korrigjimi futet në origjinalin e aktvendimit dhe jepet teksti i pastër i aktvendimit. Tekstin e pastër të aktvendimit e nënshkruan regjistruesi i cili e ka nënshkruar konkluzionin për korrigjim.

(3) Kundër konkluzionit me të cilin aktvendimi korrigjohet ose me të cilin refuzohet propozimi për korrigjim, lejohet ankesë e veçantë.

E drejta për ankesë dhe kompetenca për vendosje sipas ankesës

Neni 44

(1) Kundër aktvendimit për regjistrim lejohet ankesë.

(2) Sipas ankesës kundër aktvendimit të shkallës së parë, përkatësisht kur është paraparë mundësia për të drejtën e ankesës së veçantë sipas konkluzionit, si organ i shkallës së dytë vendos Komisioni për ankesa.

(3) Ankesa parashtrohet në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit në formë me shkrim, përkatësisht nga dita e publikimit të tij në ueb faqen e Regjistrimit Qendror të Republikës së Maqedonisë kur ai është dorëzuar në formë elektronike.

(4) Parashtruesi i ankesës nuk mund të thirret në të dhënat, të cilat nuk i ka futur në fletëparaqitjen për regjistrim dhe në shtojcat që nuk i ka dërguar.

(5) Kur me këtë ligj është caktuar e drejta e ankesës për konkluzion, kurse nuk është caktuar afati për ankesën e veçantë, afati është tri ditë nga dita e pranimi të konkluzionit në formë me shkrim, përkatësisht nga dita e publikimit të tij në ueb faqen e Regjistrimit Qendror të Republikës së Maqedonisë nëse është dorëzuar në formë elektronike.

Paraqitja e ankesës

Neni 45

(1) Ankesa në mënyrë të drejtpërdrejtë paraqitet ose dërgohet me postë të rekomanduar në Regjistrin qendror.

(2) Nëse ankesa është dërguar ose i është paraqitur në mënyrë të drejtpërdrejtë Komisionit për ankesa, konsiderohet si t'i jetë paraqitur Regjistrin qendror.

Veprimi i organit të shkallës së parë sipas ankesës

Neni 46

(1) Regjistri qendror kontrollon nëse ankesa është lejuar, është në kohë dhe është paraqitur nga personi i autorizuar.

(2) Ankesa e palejuar, jo në kohë ose nga personi i paautorizuar hedhet poshtë me aktvendim.

(3) Ankesa jo në kohë që i është paraqitur ose që i është dërguar drejtpërdrejt Komisionit për ankesa, vlerësohet sipas ditës kur është pranuar nga Komisioni për ankesa.

(4) Kundër aktvendimit me të cilin hedhet poshtë ankesa në bazë të paragrafit (2) nga ky nen, parashtruesi i kërkesës për regjistrim ka të drejtë për ankesë. Nëse Komisioni për ankesa konstaton se ankesa është e arsyeshme, do të vendosë njëkohësisht edhe sipas ankesës që është hedhur poshtë.

Vendosja sipas ankesës

Neni 47

(1) Nëse Regjistri qendror konstaton se ankesa është e arsyeshme, ndërsa nuk është e nevojshme të ngrihet procedurë e re, kërkesën në fletëparaqitjen për regjistrim mund ta miratojë, dhe me aktvendim të ri ta zëvendësojë aktvendimin që hedhet poshtë me ankesën.

(2) Nëse Regjistri qendror nuk vepron sipas paragrafit (1) nga ky nen, është i detyruar që pa shtyrje, ankesën bashkërisht me shkresat ta dërgojë për vendosje në Komisionin për ankesa.

Përbërja e Komisionit për ankesa

Neni 48

(1) Komisioni për ankesa ka tre anëtarë, prej të cilëve një kryetar dhe dy anëtarë, dhe zëvendësit e tyre.

(2) Anëtarët e Komisionit për ankesë i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë..

(3) Anëtarët e komisionit për ankesa emërohen nga radhët e juristëve të diplomuar me provimin e dhënë të jurisprudencës dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet në punë juridike pas dhënies së provimit. Emërimi bëhet për një periudhë prej katër vjetësh, me atë që i njëjti person mund të emërohet përsëri.

(4) Në Komisionin për ankesa, nuk mund të jetë anëtar personi i punësuar, ose i emëruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë.

(5) Qeveria e Republikës së Maqedonisë mund ta shkarkojë anëtarin e Komisionit për ankesa para skadimit të afatit për të cilin është emëruar, edhe atë:

- 1) me kërkesën e anëtarit të Komisionit për ankesa,
- 2) nëse anëtari i Komisionit për ankesa nuk e kryen funksionin e vet në pajtim me ligjin, sipas procedurës paraprakisht të realizuar dhe gjendjes së konstatuar faktike,
- 3) nëse është dënuar për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj, ose i është shqiptuar masa e sigurisë ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj,
- 4) në rast të pengimit për kryerjen e funksionit për shkak sëmundjes më shumë se gjashtë muaj,
- 5) keqpërdorimit të funksionit.

Mënyra e punës dhe vendosjes së Komisionit për ankesa

Neni 49

- (1) Komisioni punon dhe vendos në këshill prej tre anëtarësh. Vendimet i merr këshilli me shumicë votash.
- (2) Komisioni emëron sekretar të Komisionit, i cili i kryen punët profesionale për punën dhe vendosjen e komisionit nga radhët e të punësuarve në Regjistrin qendror.
- (3) Komisioni për ankesa miraton Rregullore pune me të cilën e rregullon mënyrën e punës dhe vendosjes.

Vendosja e Komisionit për ankesa

Neni 50

- (1) Komisioni për ankesa do ta hedhë poshtë ankesën nëse ankesa nuk është e lejuar, nëse është jo në kohë ose është parashtruar nga personi i paautorizuar.
- (2) Komisioni për ankesa mund ta refuzojë ankesën, ta pranojë ankesën, ta prishë aktvendimin pjesërisht ose plotësisht, ose ta ndryshojë aktvendimin.
- (3) Komisioni për ankesa do ta refuzojë ankesën kur do të konstatojë se procedura që i ka paraprirë aktvendimit është zbatuar sipas rregullit dhe se aktvendimi është bazuar në ligj, ndërsa ankesa e pabazë.

Veprimi i Komisionit për ankesa sipas vendimit të pavlefshëm

Neni 51

- (1) Nëse Komisioni për ankesa konstaton se në procedurën e shkallës së parë është bërë cenim, i cili aktvendimin e bën të pavlefshëm, do ta shpallë aktvendimin e tillë të pavlefshëm.
- (2) Nëse Komisioni për ankesa konstaton se aktvendimin e shkallës së parë nuk e ka marrë regjistruesi, do ta prishë atë aktvendim me detyrë zyrtare dhe lëndën do t'ia paraqesë Regjistrin qendror për zgjidhje.

Prishja dhe ndryshimi i vendimit të shkallës së parë

Neni 52

Nëse Komisioni për ankesa konstaton se në procedurën e shkallës së parë janë bërë cenime që kanë pasur ndikim në zgjidhjen e kërkesës për regjistrim, ose se dispozitivi i aktvendimit të hedhur poshtë është i paqartë, ose se gabimisht është zbatuar ligji në bazë të të cilit vendoset sipas fletëparaqitjes për regjistrim, me aktvendimin e vet ai do ta prishë aktvendimin e shkallës së parë dhe do ta paralajmërojë regjistruesin se në cilin drejtim duhet të plotësohet procedura për regjistrim, ndërsa regjistruesi është i detyruar në gjithë çka të veprojë sipas aktvendimit të shkallës së dytë dhe pa shtyrje të marrë aktvendim të ri.

Ndryshimi i aktvendimit edhe përkundër kërkesës së vënë në ankesë

Neni 53

Me qëllim të zgjidhjes së drejtë të kërkesës për regjistrim, Komisioni për ankesa me rastin e ankesës mund ta ndryshojë aktvendimin në favor të ankuesit, edhe për kundër kërkesës së vënë në ankesë, e në suazat e kërkesës së vënë në procedurën e shkallës së parë.

Ankesa kur vendimi i shkallës së parë nuk është marrë

Neni 54

Nëse ka deklaruar ankesë parashtruesi i fletëparaqitjes për regjistrim sipas kërkesës së të cilit regjistruesi nuk ka marrë aktvendim në afatet e përcaktuara me këtë ligj, Komisioni për ankesa nëse konstaton se nuk është marrë aktvendim në afat për shkaqe të arsyeshme, regjistruesit do t'i caktojë afat për marrjen e aktvendimit, i cili nuk mund të jetë më shumë se pesë ditë. Nëse shkaqet për shkak të së cilave nuk është marrë aktvendimi në afat nuk janë të arsyeshme, Komisioni për ankesa do të kërkojë që regjistruesi t'ia dërgojë shkresat e lëndës në zgjidhje dhe më pas vetë do ta zgjidhë çështjen. Ky vendim është definitiv.

Afati për marrjen e vendimit sipas ankesës

Neni 55

(1) Aktvendimi sipas ankesës doemos të merret dhe t'i dërgohet palës në afatin sa më të shkurtër të mundur, kurse më së voni në afat prej 14 ditësh, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së ankesës.

(2) Nëse pala heq dorë nga ankesa, procedura sipas ankesës ndërpritet me konkluzion.

Zbatimi i ligjit dhe mbrojtja gjyqësore

Neni 56

(1) Në mungesë të dispozitave për procedurën e regjistrimit të përcaktuar me këtë ligj, zbatohet Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, me përjashtim të dispozitat nga neni 114, 115, 116, 117, 121, 122, 123,124 dhe 125.. ⁴

(2) Kundër aktvendimit definitiv mund të ngrihet kontest administrativ.

Data, koha e regjistrimit dhe shpallja e të dhënave të regjistruara

Neni 57

(1) Të dhënat nga fletëparaqitja për regjistrim, konsiderohen për të regjistruara në regjistër me ditën e marrjes së aktvendimit, përveç nëse me ligj tjetër nuk është e përcaktuar ndryshe.

(2) Të dhënat e regjistruara në regjistrat themelorë, shpallen në ueb faqen e Regjistratit qendror.

(3) Regjistrimi i të dhënës së regjistruar në regjistrin themelor ka veprim juridik ndaj personave të tretë ditën e ardhshme nga dita e shpalljes së bërë sipas paragrafit (2) nga ky nen, përveç nëse me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

4. REGJISTRIMI I SHLYERJES NGA REGJISTRIT DHE SUBJEKTI JOAKTIV I REGJISTRIMIT

Shlyerja e regjistrimit në regjistër

Neni 58

Kur janë plotësuar kushtet për shlyerjen e subjektit të regjistruar në regjistër, ose të ndonjë të dhëne të regjistruar të subjektit të regjistruar në bazë të vendimit të plotfuqishëm, ose në bazë të ligjit, regjistruesi me detyrë zyrtare merr aktvendim për shlyerjen e regjistrimit nga regjistri.

Shlyerja e regjistrimit sipas detyrës zyrtare

Neni 59

(1) Kur me vendim të plotfuqishëm është konstatuar se mbi subjektin e regjistruar ka filluar procedura e likuidimit ose falimentimit, procedura për riorganizim, ose procedura tjetër që i dedikohet të dhënës së regjistruar në regjistër, regjistruesi me detyrë zyrtare merr aktvendim për regjistrimin e asaj të dhëne. Pas zbatimit të procedurës për falimentim gjegjësisht likuidim bëhet regjistrimi i shlyerjes së subjektit në regjistrim në regjistrin përkatës. Organi i cili e ka zbatuar procedurën pas përfundimit të së njëjtës, pa prolongim Regjistrin qendror i parashton dëshmi për këtë (aktvendim i plotfuqishëm) dhe dëshmi për pagesën e kompensimit të harxhimeve të Regjistrin qendror, në bazë të të cilit regjistruesi merr vendim për shlyerje me të cilin subjekti në regjistrim e shlyen në regjistrin përkatës. Aktvendimi për shlyerjen e subjektit në regjistrim ka veprim juridik ndaj personave të tretë nga dita kur është paraqitur në ueb faqen e Regjistrin qendror

(2) Regjistruesi, organit nga paragrafi (1) të këtij neni do t'i paraqesë kopje nga aktvendimi për shlyerjen e subjektit në regjistrim nga regjistri.

Qasja në të dhënat e shlyera

Neni 60

(1) Shlyerja në regjistër e subjektit të regjistruar në regjistrim ose të së dhënës së regjistruar për subjektin në regjistrim, mbetet e evidentuar në regjistër me shenjë "subjekt i shlyer në regjistrim. ose "e dhënë e shlyer" gjatë së cilës shënohet arsyeja e shlyerjes dhe koha e shlyerjes.

(2) Të gjitha të dhënat e shlyera në regjistër të subjektit të regjistruar në regjistrim, vazhdimisht ruhen në regjistër dhe janë të kapshme për personat e interesuar, nën kushtet me të cilat janë të kapshme të dhënat tjera, të cilat i udhëheq Regjistri qendror.

Evidentimi i subjektit joaktiv në regjistrim

Neni 61

(1) Subjektit të regjistruar, i cili nuk i ka paraqitur llogari vjetore ose raport financiar Regjistrin qendror, Regjistri qendror i jep statusin "Joaktiv" që shënohet në regjistrimin e tij dhe shpallet në ueb faqen e Regjistrin qendror.

(2) Me kërkesën e personit të autorizuar shlyhet statusi i subjektit joaktiv në regjistrim, nëse subjekti i regjistrimit:

- paraqet llogarinë vjetore ose raportin financiar;
- vërteton formularin për identitetin e të dhënave të regjistruara në regjistër në pajtim me nenin 67 paragrafi (5) nga ky ligj.
- paguan kompensimin për shërbimin e kryer.

5. KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE

Neni 62

Për shërbimet e kryera që kanë të bëjnë me regjistrimet në regjistrat, ankesat sipas regjistrimeve, përpunimit, bashkimit, klasifikimit, seleksionimit, deponimit, ruajtjes dhe shfrytëzimit të së dhënave të regjistruara në regjistrat gjatë shlyerjes së regjistrimeve në regjistra dhe shtojcave si dhe distribuimi i të dhënave, të shfrytëzuesit e interesuar dhe çështjet tjera, të cilat në pajtim me këtë ligj i bën Regjistri qendror, paguhet kompensim i përcaktuar në pajtim me Tarifën e Regjistrin qendror.

IV SANKSIONE PËR KUNDËRVAJTJE

Kundërvajtjet

Neni 63

(1) Gjobë në një shumë prej 2.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personi juridik, i cili udhëheq regjistër themelor ose regjistër të veçantë nëse Regjistrin qendror nuk ia paraqet të dhënat me të cilat disponon, nuk i mundëson shfrytëzimin e tyre të papenguar, ose nuk i jep sqarim dhe ndihmë në lidhje me kryerjen e punëve nga kompetencat e tij (neni 5 paragrafi (1)).

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e llogaritur për personin juridik, do ti shqiptohet personit përgjegjës në person juridik për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 64

I fshirë 5

Neni 65

(1) Gjobë në një shumë prej 2.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik që udhëheq regjistër themelor ose regjistër të veçantë nëse Regjistrin qendror:

- nuk i paraqet kopje të aktvendimit për regjistrimin e bërë në regjistër (neni 13 paragrafi 1));
- nuk i bart të dhënat e regjistruara në formë elektronike në bazë të planit të miratuar nga Regjistri qendror (neni 72).

(2) Gjobë në shume prej 30% nga gjoba e llogaritur e personit juridik, do ti shqiptohet personit përgjegjës në person juridik për veprimet nga

paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 66

(1) Gjobë në një shumë prej 2.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik, i cili nuk do ta udhëheqë dhe nuk do ta shfrytëzojë NUAS si identifikues të vetmin në pajtim me nenin 6 (neni 71 paragrafi (2)).

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e llogaritur e personit juridik, do ti shqiptohet personit përgjegjës në person juridik për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 66-a

(1) Gjobë në shumë prej 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet subjektit për regjistrim, nëse nuk vepron në pajtim me nenin 21 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e llogaritur e personit juridik, do ti shqiptohet personit përgjegjës në person juridik për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 66-b

Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik kryhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

V DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Regjistri unik tregtar

Neni 67

(1) Regjistri unik tregtar në territor të Republikës së Maqedonisë do të vendoset deri më 31.12.2005.

(2) Prej 01.01.2006 Regjistri qendror merr nga gjykatat kompetente udhëheqjen e regjistrit tregtar, së bashku me kalimin e të dhënave të regjistruara, të cilat udhëhiqen në regjistrat tregtarë të Gjykatës Themelore I në Shkup, Gjykatës Themelore në Manastir dhe Gjykatës Themelore në Shtip.

(3) Gjykata Themelore Shkup I në Shkup, Gjykata Themelore në Manastir dhe Gjykata Themelore në Shtip, janë të detyruar që më së voni deri më 31.10.2005, sipas dinamikës të cilën do ta përcaktojnë me Regjistrin qendror, ta paraqesin dokumentacionin e tyre për subjektet në regjistrim, të cilat janë regjistruar në regjistrat tregtarë përfundimisht me 31.12.2004, edhe atë: bazën elektronike të të dhënave, librin kryesor, dosjet regjistruese, përmbledhjet e dokumenteve, protokollet dhe tërë dokumentacionin tjetër, i cili është vendosur për udhëheqjen e regjistrave. Nëse një pjesë e dokumentacionit fizikisht nuk mund të ndahet nga dokumentacioni gjyqësor i Regjistrit qendror, i jepet kopje nga ajo pjesë e dokumentacionit gjyqësor. Dokumentacioni i marrë mbetet në ruajtje të përhershme te Regjistri qendror.

(4) Kalimi i të dhënave nga paragrafi (2) të këtij neni për regjistrimet e bëra në regjistrat tregtarë prej 01.01.2005 përfundimisht me 31.12.2005, do të bëhet në kontinuitet sipas dinamikës që do ta përcaktojnë gjykatat

kompetente nga paragrafi (2) të këtij neni dhe Regjistri qendror më së voni deri më 31.12.2005.

(5) Pas kalimeve të të dhënave nga regjistrat tregtarë nga paragrafi (2) dhe (3) të këtij neni nga forma e shkruar në formën elektronike, Regjistri qendror dërgon aktvendim nga regjistri unik tregtar deri te subjekti i regjistrimit, i cili është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, ta vërtetojë identitetin e të dhënave të regjistruara në regjistrat nga paragrafi (2) dhe paragrafi (3) të këtij neni me aktvendimin në regjistrin unik tregtar. Vërtetimi bëhet nga përfaqësuesi sipas ligjit me deklaratë në formular të përcaktuar nga Regjistri qendror.

(6) Subjekti i regjistrimit ka të drejtë për ankesë ndaj vendimit, në lidhje me identitetin e të dhënave të regjistruara në regjistrat, në afat prej 8 ditësh pas pranimit të aktvendimit nga paragrafi (4) të këtij neni.

(7) Subjektet në regjistrim, të cilat nuk do ta plotësojnë obligimin nga paragrafi (5) të këtij neni, Regjistri qendror i evidenton si subjekt joaktiv në regjistrim.

Marrja e regjistrave gjyqësorë

Neni 68

(1) Regjistri i personave tjerë juridikë do të vendoset deri më 30.09.2006.

(2) Prej 30.09.2006, Regjistri qendror e merr nga gjyqet kompetente udhëheqjen e regjistrave gjyqësorë në regjistrin e personave tjerë juridikë, së bashku me kalimin e të dhënave të regjistruara, të cilat udhëhiqen në regjistrat gjyqësorë, përveç regjistrin unik gjyqësor të partive politike.

(3) Pas kalimit të së dhënave nga regjistrat gjyqësorë nga forma e shkruar në formë elektronike, Regjistri qendror dërgon aktvendim nga regjistri i personave tjerë juridikë te subjektit i regjistrimit, i cili është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, ta vërtetojë identitetin e të dhënave të regjistruara në regjistrat me aktvendim nga regjistri i personave tjerë juridikë. Vërtetimi bëhet nga përfaqësuesi sipas ligjit, përkatësisht nga personi tjetër i autorizuar me ligj me deklaratë në formular të përcaktuar nga Regjistri qendror.

(4) Dispozita nga paragrafi (3) të këtij neni nuk zbatohet ndaj institucioneve.

(5) Gjykatat kompetente janë të detyruara që më së voni deri më 30.06.2006, sipas dinamikës të cilën do ta përcaktojnë me Regjistrin qendror, ta dërgojnë dokumentacionin e tyre për subjektet në regjistrim, të cilët janë regjistruar në regjistrat gjyqësorë, edhe atë: bazën elektronike të të dhënave, librin kryesor, dosjet regjistruese, përmbledhjen e dokumenteve, protokollin dhe tërë dokumentacionin tjetër që është vendosur për udhëheqjen e regjistrave. Nëse një pjesë e dokumentacionit fizikisht nuk mund të ndahet nga dokumentacioni gjyqësor të Regjistrin qendror, i jepet kopje kjo ajo pjesë e dokumentacionit gjyqësor.

(6) Nga regjistri gjyqësor nuk bëhet kalimi i të dhënave të regjistruara për subjektet, të cilat nuk janë harmonizuar sipas Ligjit për shoqëritë tregtare prej vitit 1996 dhe 2004. Të dhënat për subjektet në regjistrim merren në formë të shkruar siç udhëhiqen në gjyqe nga paragrafi (2) të këtij neni

dhe nuk merren në regjistrin e personave tjerë juridikë në formë të shkruar dhe elektronike.

Neni 69

(1) Subjektet në regjistrim, të cilët udhëhiqen në regjistrat tregtarë të Gjykatave Themelore Shkup I ne Shkup, Manastir dhe Shtip, në formë elektronike dhe të shkruar, që nuk kanë marrë numrin e subjektit afarist (NST) nga Enti shtetëror i statistikës, do të mund të regjistrohen në regjistrin unik tregtar nëse në pajtim me këtë ligj marrin NUAS.

(2) Nëse subjektet nga paragrafi (1) deri më 31.12.2005 nuk marrin NUAS në pajtim me këtë ligj, konsiderohet se nuk e kanë përfunduar procedurën për regjistrim në pajtim me këtë ligj, dhe subjektit të regjistruar i jepet statusi "Joaktiv".

(3) Dispozitat nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të këtij neni, zbatohen edhe ndaj subjekteve të regjistruara në regjistrat gjyqësorë. Afati nga paragrafi (2) të këtij neni rrjedh nga dita e marrjes së regjistrave gjyqësorë të përcaktuara me këtë ligj.

Vendosja sipas procedurave te filluara

Neni 70

(1) Procedurat e filluara për regjistrim në Regjistrin tregtar deri më 31 dhjetor 2005, do të përfundojnë në bazë të dispozitave sipas të cilave kanë filluar.

(2) Procedurat e filluara për regjistrim deri më 29 shtator 2006, të cilat regjistrohen në regjistrin e personave tjerë juridikë, do të përfundojnë në bazë të dispozitave sipas të cilave kanë filluar.

(3) Gjyqi pas përfundimit të procedurës për regjistrim pa shtyrje do t'ia dërgojë aktvendimin me dokumentacionin e plotë Regjistrit qendror.

Zëvendësimi i numrit ose identifikuesit tjetër me NUAS

Neni 71

(1) Dispozitat me të cilat për së afërmi rregullohen mënyra, forma dhe përmbajtja e instrumenteve të zbatuara për zbatimin e dispozitave nga ky ligj, me të cilat rregullohet NUAS, organet dhe organizatat kompetente do t'i harmonizojnë me dispozitat e këtij ligji më së voni deri më 31.12.2005.

(2) Organet shtetërore kompetente, organizatat dhe institucionet tjera kanë obligim që në bazat e tyre të të dhënave, ose të llojit tjetër të evidencës ta fusin dhe në komunikimin e ndërsjellë ta shfrytëzojnë numrin unik amë të subjektit në regjistrim (NUAS) si identifikues të vetëm më së voni deri më 30.06.2006.

Obligimi për kalimin e të dhënave

Neni 72

(1) Kalimi i të dhënave që janë regjistruar në regjistrat themelorë, ose evidencat tjera, të cilat udhëhiqen në pajtim me ligjin për zejtarët, avokatët, noterët, bujqit individualë dhe organizatat e sindikatës, bëhet

nga forma e shkruar në formën elektronike më së voni deri më 30.06.2006.

(2) Kalimi i të dhënave nga paragrafi (1) të këtij neni do të bëhet sipas planit për kalimin e të dhënave të cilin Regjistri qendror do ta miratojë në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 73

(1) Rregulloren për formularë të paraparë me këtë ligj, Ministri i Ekonomisë do ta miratojë në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Emërimi i regjistruarit do të bëhet në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(3) Emërimi i anëtarëve të Komisionit për ankesa do të bëhet në afat prej 90 i ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 74

(1) Nga dita kur Regjistri qendror do të filloj ta aplikoj nënshkrimin elektronik në pajtim me Ligjin për të dhënat në formë elektronike dhe nënshkrim elektronik, parashtruesi i cili fletëparaqitjen për regjistrim dhe dokumentet shtesë ndaj fletëparaqitjes i ka dërguar në formë elektronike, nuk është i detyruar të njëjtat t'i dërgoj edhe në formë të shkruar.

(2) Nga dita kur Regjistri qendror do të filloj ta zbatojë nënshkrimin elektronik në pajtim me Ligjin për të dhënat në formë elektronike dhe nënshkrimin elektronik, afati nga neni 41 paragrafi (3) i këtij ligji llogaritet nga dita e pranimit të fletëparaqitjes për regjistrim dhe dokumentet shtesë ndaj fletëparaqitjes të cilat parashtrohen në formë elektronike.

Neni 75

(1) Prej 01.01.2006 pushon të vlejë Ligji për klasifikimin nacional të veprimtarive "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 7/98.

(2) Regjistri qendror punët nga neni 4 të këtij ligji do t'i bëjë nëpërmjet sistemit njësportel duke filluar prej 01.01.2006

Hyrja në fuqi e këtij ligji

Neni 76

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

DISPOZITA NGA LIGJE TË TJERË

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sistemin njësportel dhe për udhëheqjen e regjistrimit tregtar dhe regjistrimit të personave të tjerë juridikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/2007):

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë". [6](#)

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sistemin njësportel dhe për udhëheqjen e regjistrimit tregtar dhe

regjistrin të personave të tjerë juridikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/2007):

Neni 16

Punët nga neni 2 alinetë 7 dhe 8, neni 9 dhe 11 do të kryhen nëpërmjet sistemit njësportel duke filluar nga 1 korriku 2008.

Neni 17

Për të gjitha subjektet e regjistruara në regjistrin tregtar deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji automatikisht vlen klauzola për biznes.

Neni 18

Aktet nënligjore të cilat dalin nga ky ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sistemin njësportel dhe për udhëheqjen e regjistrin tregtar dhe regjistrin të personave të tjerë juridikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/2008):

Neni 5

Bartja e të dhënave nga neni 13 të këtij ligji bëhet nga forma e shkruar në formë elektronike më së voni deri më 30 shtator 2009.

Bartja e të dhënave nga paragrafi 1 i këtij neni do të bëhet sipas planit për bartjen e të dhënave të cilat Regjistri qendror do ta miratojë në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 6

Dispozitat e parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sistemin njësportel dhe për udhëheqjen e regjistrin tregtar dhe regjistrin të personave të tjerë juridikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/2011):

Neni 18

Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë do të zbatojë paraqitje të të dhënave afariste dhe financiare për subjektet që janë regjistruar në regjistra dhe të dhënave tjera me të cilat disponon, në gjuhë softuerike të standardizuar, të pranuar ndërkombëtarisht nga 1 janari 2013.

Neni 19

Rregullat e parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 20

Subjektet për regjistrim të regjistruara në regjistrin tregtar dhe regjistrin e personave të tjerë juridikë, detyrohen që më së voni deri më 1 prill 2011 të parashetrojnë fletëparaqitje për regjistrim në adresë të postës elektronike për dorëzimin e dokumenteve dhe të dhënave tjera që miratohen, në formë elektronike nëpërmjet sistemit njësportel.

Ligj për ndryshimin e Ligjit për sistemin njësportel dhe për udhëheqjen e regjistrin tregtar dhe regjistrin të personave të tjerë juridikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2011):

Neni 2

Akti nënligjor nga neni 41-a paragrafi (2) i këtij ligji do të miratohet në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Ligj për ndryshimin e Ligjit për sistemin njësportel dhe për udhëheqjen e regjistrimit tregtar dhe regjistrimit të personave të tjerë juridikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 70/2013):

Neni 6

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sistemin njësportel dhe për udhëheqjen e regjistrimit tregtar dhe regjistrimit të personave të tjerë juridikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 115/2014):

Neni 4

Për fletëparaqitjet për regjistrim të parashtruara nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 31 dhjetor 2014, regjistrimi në adresën e kutisë elektronike për pranim të shkresave do të bëhet pa kompensim, përveç për fletëparaqitjen për regjistrim të ndryshimit të adresës së kutisë elektronike për pranim me shkrim.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sistemin një sportel dhe për udhëheqjen e regjistrimit tregtar dhe regjistrimit të personave të tjerë juridikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 97/2015):

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", e do të fillojë të zbatohet nga 1 nëntori 2015.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sistemin një sportel dhe për udhëheqjen e regjistrimit tregtar dhe regjistrimit të personave të tjerë juridikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2016):

Neni 5

Dispozitat nga neni 1 dhe neni 4 nga ky ligj do të fillojnë të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative në pajtim me nenin 141 nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

